

## Manuali i Fotove për investimet GEF

Datë 15.12.2023

Për t'u kualifikuar për grant, klientët që kanë marrë kredi GEF duhet të respektojnë rregullat për kualifikim në programin GEF si dhe të ofrojnë dëshmi të teknologjive të financuara të blera dhe të instaluara (prova/dëshmitë fotografike).

Ky Manual ofron udhëzime se si të përgatisni fotot/provat fotografike për Konsulentin e Projektit i cili është përgjegjës për verifikimin e projektit.

Është e nevojshme të siguroni fotografitë e projektit **para** fillimit të punimeve, **gjatë** instalimit dhe **pas** përfundimit të punimeve të instalimit. Rekomandohet që fotot të merren nga i njëjti vend/pozicion para dhe pas zbatimit në mënyrë që të mundësohet krahasimi i fotografive para dhe pas.

Në rast se nuk ofrohen prova fotografike ose fotot janë të pamjaftueshme, Konsulenti i Projektit mund të kërkojë dokumentacion shtesë ose të bëjë vizitë në terren ose ta refuzojë projektin.

### 1 Dritaret, dyert, xhami

Për dritare/dyer është e nevojshme të bëni fotografi **para**, **gjatë** dhe **pas** përfundimit të punimeve të instalimit.

Përpara instalimit, duhet të bëhen fotografi për të dokumentuar situatën ekzistuese. Në rast se do zëvendësoni dritaret/dyert ekzistuese, ju lutemi bëni një fotografi të secilës fasadë duke treguar dritaret/dyert ekzistuese (tërë fasada duhet të tregohet në fotografi). Në rast të një ndërtimi të ri, është e nevojshme të bëni një fotografi të secilës fasadë e cila tregon hapjet bosh për dritare/dyer (tërë fasada duhet të tregohet në fotografi).

Gjatë instalimit, duhet të bëni fotografi që të tregohen punimet aktuale dhe emri i modelit të dritareve dhe dyerve.

Pas përfundimit të punimeve, është e nevojshme të bëni fotografi për secilën fasadë që tregon dritaret/dyert e reja (në fotografi duhet të tregohet tërë fasada) dhe duhet bërë nga afër një foto e tipit të dritareve/dyerve të instaluara (fotografia e zmadhuar në kënd të dritares).




Supported by:



Kërkesat e nevojshme janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Fotografi para instalimit/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e <b>secilës fasadë</b> ku janë instaluar dritaret dhe dyert e jashtme</li> <li>▪ Fotografi gjatë instalimit (duke treguar punimet e instalimit)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e <b>secilës fasade</b> ku janë instaluar dritaret dhe dyert e jashtme (fotografitë duhet të jenë të tilla që Konsulenti i Projektit ti numërojë të gjitha dritaret dhe dyert e jashtme të sapo instaluara, roletat, rrjetat kundër mushkonjave, etj.)</li> <li>▪ Fotografi e zmadhuar e një dritareje të re (këndi i dritares)</li> <li>▪ Fotografi që tregon markën/modelin e dritareve/dyerve të reja</li> </ul>

**Shembull: instalimi i dritareve/dyerve të reja**

Fotografi para instalimit/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e fasadës 1 me dritaret/dyert ekzistuese (tërë fasada)</li> <li>▪ Fotografi e fasadës 2 me dritaret/dyert ekzistuese (tërë fasada)</li> <li>▪ Fotografi e fasadës 3 me dritaret/dyert ekzistuese (tërë fasada)</li> <li>▪ Fotografi e fasadës 4 me dritaret/dyert ekzistuese (tërë fasada)</li>   <li>▪ Fotografi gjatë instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e fasadës 1 me dritare/dyer të reja (tërë fasada)</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e fasadës 2 me dritare/dyer të reja (tërë fasada)</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e fasadës 3 me dritare/dyer të reja (tërë fasada)</li> </ul> 

Supported by:



- Fotografi e fasadës 4 me dritare/dyer të reja (tërë fasada)



- Fotografi e zmadhuar e një dritareje të re (këndi i dritares)



- Marka/Modeli i dritares së re



## 2 Izolimi i mureve të jashtme

Për izolimin termik të mureve është e nevojshme të bëni fotografi **para**, **gjatë** dhe **pas** përfundimit të punimeve të montimit.

Përpara zbatimit të projektit, duhet të bëni fotografi të secilës fasade ekzistuese e cila do të izolohet (tërë fasada duhet të tregohet në fotografi). Fotografitë e mureve të jashtme duhet

Supported by:



të bëhen nga jashtë. Në rast se termoizolimi do të vendoset brenda mureve, ju lutemi bëni një fotografi të murit të brendshëm përpara instalimit.

Përveç kësaj, duhet të bëhen fotografi gjatë procesit të instalimit që tregojnë punën aktuale, trashësinë e materialit izolues (duke matur trashësinë me masë shiriti, vizore, etj.) dhe emrin e markës/modelit të materialit izolues (stiroporit/stirodurit, etj.).

Pas përfundimit të plotë të izolimit, duhet të bëni fotografi nga të gjitha fasadat që janë izoluar (tërë fasada duhet të tregohet në fotografi).

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e secilës fasade (tërë fasada)</li> <li>▪ Fotografi e punimeve të instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e <b>secilës fasade të izoluar</b> (tërë fasada)</li> <li>▪ Fotografi e matjes së trashësisë së materialit kryesor të izolimit</li> <li>▪ Fotografi e materialit kryesor izolues (emri i markës/modelit)</li> </ul>

**Shembull:**

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit

Supported by:



- Fotografi e fasadës 1



- Fotografia e fasadës 2



- Fotografia e fasadës 3



- Fotografia e fasadës 4



- Fotografi e fasadës 1 pas izolimit të mureve



- Fotografia e fasadës 2 pas izolimit të mureve



- Fotografia e fasadës 3 pas izolimit të mureve



- Fotografia e fasadës 4 pas izolimit të mureve



- Fotografia e materialit kryesor izolues (trashësia)

Supported by:



- Foto e punimeve të instalimit



- Fotografia e markës/modelit të materialit kryesor izolues të blerë dhe transportuar në shtëpi



Shënim:

Shembulli i projektit të mësipërm nuk është e njëjta ndërtesë siç tregohet në pjesën "pas instalimit të projektit". Megjithatë, fotot shërbejnë për të treguar tipin e fotografive që kërkohen si dëshmi të investimit të kryer.

### 3 Izolimi i çatisë, kati i fundit

Për izolimin e kulmit (ose izolimin e katit të fundit poshtë çatisë/kulmit), është e nevojshme të paraqisni **fotografi përpara instalimit, gjatë instalimit dhe pas përfundimit** duke përfshirë të gjitha shtresat mbrojtëse, ku mund të aplikohet kjo.

Përpara zbatimit të projektit, është e nevojshme të bëni një fotografi të pamjes së përgjithshme të strukturës ekzistuese të çatisë/kulmit (ose katit të fundit) që do të izolohet. Fotografitë duhet të bëhen nga ana ku do të aplikohet izolimi termik.

Përveç kësaj, gjatë instalimit duhet të bëhen fotografi që tregojnë punën aktuale, trashësinë e materialit kryesor izolues (duke matur trashësinë me masë shiriti, vizore, etj.) dhe emrin e markës/modelit të materialit kryesor izolues.

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:






Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e çatisë/kulmit ose katit të fundit përpara instalimit</li> <li>Fotografi gjatë punimeve të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e çatisë/kulmit, kati i fundit</li> <li>Fotografi e matjes së trashësisë së materialit kryesor izolues</li> </ul>

Supported by:



instalimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e materialit kryesor izolues (emri i markës/modeli)</li> </ul>
------------	---

**Shembull (izolimi i katit të fundit nën çati/kulm):**

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e katit të fundit para instalimit të izolimit</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi gjatë punimeve të instalimit</li> </ul> 	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi pas instalimit</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e materialit kryesor izolues që tregon trashësinë</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e markës/modelit të materialit kryesor izolues</li> </ul> 

## 4 Izolimi i dyshemesë

Për izolimin e dyshemesë (p.sh.. izolimi i tavanit nën bodrum ose izolimi i dyshemesë nga lart), është e nevojshme të bëni fotografi **para, gjatë** dhe **pas përfundimit të punimeve**.



Përpara zbatimit të projektit, është e nevojshme të bëhet fotografi e pamjes së përgjithshme të dyshemesë/dhomës ekzistuese e cila do të izohet. Fotografitë duhet të merren nga ana ku do të aplikohet izolimi termik.

Përveç kësaj, gjatë procesit të instalimit duhet të bëhen fotografi që tregojnë punën aktuale, trashësinë e materialit kryesor izolues (duke matur trashësinë me masë shiriti, vizore, etj.) dhe emrin e markës/modelit të materialit kryesor izolues.

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Foto para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e dyshemesë para instalimit</li> <li>Fotografi gjatë punimeve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e dyshemesë</li> <li>Fotografi e matjes së trashësisë së materialit kryesor izolues</li> <li>Fotografi e materialit kryesor izolues (emri i markës/modelit)</li> </ul>

**Shembull (izolimi i tavanit të bodrumit fotografuar nga poshtë):**

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e tavanit të bodrumit para instalimit</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi gjatë punimeve të instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Foto e tavanit të bodrumit</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e materialit kryesor izolues (matja e trashësisë)</li> </ul>

Supported by:







- Fotografi e materialit kryesor izolues (emri i markës/modeli)



## 5 Izolimi i mureve ndarëse <sup>1</sup>

Për izolimin e mureve ndarëse është e nevojshme të bëni fotografi **para, gjatë** dhe **pas përfundimit** të punimeve.

Përpara zbatimit të projektit, është e nevojshme të bëni një fotografi të murit ndarës i cili do të izolohet. Fotografitë duhet të bëhen nga ana ku do të aplikohet izolimi.




Përveç kësaj, gjatë procesit të instalimit duhet të bëhen fotografi që tregojnë punën aktuale, trashësinë e materialit kryesor izolues (duke matur trashësinë me masë shiriti, vizore, etj.) dhe emrin e markës/modelit të materialit kryesor izolues.

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e murit ndarës pa izolim</li> <li>▪ Fotografi gjatë punimeve të instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><input type="checkbox"/> Fotografia e murit ndarës</li> <li><input type="checkbox"/> Fotografia e matjes së trashësisë së materialit kryesor izolues</li> <li><input type="checkbox"/> Fotografi e materialit kryesor izolues (emri i markës/modeli)</li> </ul>

<sup>1</sup> Shënim: muret ndarëse janë zona ndarëse me kërkesa të ndryshme të temperaturës së brendshme (shembull: muri ndërmjet shkallëve (pa ngrohje) dhe banesës)

**Shembull (muri ndarës me dhomën e magazinimit pa ngrohje):**

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografia e murit ekzistues</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografia gjatë punimeve të instalimit</li> </ul> 	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografia e murit të izoluar</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografia e materialit kryesor izolues (matja e trashësisë)</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografia e materialit kryesor izolues (emri i markës/modeli)</li> </ul> 

**6 Pompat e nxehtësisë**

Për instalimin e pompave të nxehtësisë është e nevojshme të bëni fotografi **para, gjatë** dhe **pas përfundimit të punimeve**.

Përpara zbatimit, është e nevojshme të bëni një fotografi të ambienteve dhe vendndodhjes ku do të instalohet pompa e nxehtësisë. Në rast se një kaldajë zëvendësohet me pompë të nxehtësisë, duhet të bëhet fotografia e kaldajës së vjetër.

Pas zbatimit është e nevojshme të bëni fotografi të pompës së instaluar të nxehtësisë (në rast se keni njësitë e ndara brenda dhe jashtë, ju lutemi bëni fotografinë e dy njësisve).

Përveç kësaj, gjatë procesit të instalimit duhet të bëhen fotografi që tregojnë punën aktuale dhe etiketat me veçoritë e pompës së nxehtësisë. Në rast të përdorimit të pajisjeve ndihmëse si sistemi i ngrohjes në dysheme, radiatorë etj., ju lutemi bëni edhe fotografitë e sistemit/radiatorëve të ngrohjes në dysheme.

Supported by:



Për pompat e nxehtësisë gjeotermale (që e përdorin tokën ose ujërat nëntokësore si burim nxehtësie), është e nevojshme të bëhen fotografi të punimeve të instalimit të vendosjes së tubacioneve të jashtëm në tokë.

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

<b>Fotografi para/gjatë instalimit</b>	<b>Fotografi pas instalimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e ambientit dhe vendndodhjes ku do të vendoset pompa e nxehtësisë</li> <li>Fotografi e punimeve të instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e pompës së re të nxehtësisë (në rast se keni njësi të ndara, të brendshme dhe të jashtme, ju lutemi bëni një fotografi të dy njësive)</li> <li>Fotografia e etiketës me të dhënat (duke përfshirë prodhuesin, modelin, specifikimet teknike)</li> <li>Fotografitë e pajisjeve ndihmëse të instaluara (p.sh. sistemi i ngrohjes në dyshe, radiatorët)</li> </ul>

**Shembull:**

<b>Fotografi para/gjatë instalimit</b>	<b>Fotografi pas instalimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e vendndodhjes së pompës së nxehtësisë</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e punimeve të instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e pompës së re të nxehtësisë</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e etiketës me të dhënat (duke përfshirë prodhuesin, modelin, specifikimet teknike)</li> </ul>



- Fotografi e pajisjeve ndihmëse të instaluar (p.sh. sistemi i ngrohjes në dysheme, radiatorët, etj.)



## 7 Kaldajat

Për instalimin e kaldajave është e nevojshme të bëni fotografi **para, gjatë dhe pas përfundimit të punimeve**.

Përpara zbatimit të projektit, është e nevojshme të bëhet fotografi e ambienteve dhe vendndodhjes ku do të vendoset kaldaja e re (ose fotografinë e kaldajës së vjetër e cila do të ndërrohet/zëvendësohet).

Pas zbatimit të projektit është e nevojshme të bëni fotografi të kaldajës së instaluar.

Përveç kësaj, gjatë instalimit duhet të bëni fotografi që tregojnë punën aktuale dhe etiketën me të dhënat e kaldajës. Në rast se përdoret pajisje ndihmëse si ajo e sistemit të ngrohjes së brendshme (p.sh. radiatorë), ju lutemi bëni edhe fotografi të sistemit të ngrohjes.

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e vendndodhjes së kaldajës (ose kaldaja e vjetër që do të ndërrohet)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e kaldajës së re</li> <li>▪ Fotografi e etiketës së kaldajës me të</li> </ul>

Supported by:



<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e punimeve të montimit</li> </ul>	<p>dhënat (duke përfshirë prodhuesin, modelin, specifikimet teknike)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi të pajisjeve ndihmëse të instaluara (p.sh. radiatorët)</li> </ul>
--	---

**Shembull: Kaldaja me pelet**

<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e vendndodhjes së kaldajës (ose kaldajës së vjetër që do të ndërrohet).</li> </ul> <p>Ju lutemi bëni disa fotografi kuptimplota të vendndodhjes së kaldajës përpara dhe gjatë instalimit (për arsye praktike nuk kemi dhënë këtu shembull).</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e kaldajës së re</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e etiketës me të dhënat (duke përfshirë prodhuesin, modelin, specifikimet teknike)</li> </ul> 
--	---

**8 Panele diellore për ujë të ngrohtë**

Për instalimin e paneleve diellorë për ujë të ngrohtë është e nevojshme të bëhen fotografi para, gjatë dhe pas përfundimit të punimeve.

Përpara zbatimit të projektit është e nevojshme të bëhet fotografi të ambienteve (çatisë/kulmit) ku do të vendoset paneli diellor. Pas zbatimit është e nevojshme të bëni fotografi të panelit diellor për ujë të ngrohtë të instaluar.

Përveç kësaj, gjatë instalimit duhet të bëhen fotografi që tregojnë punën aktuale dhe etiketën me të dhënat e panelit diellor për ujë të ngrohtë. Në rast se do të përdoren pajisje ndihmëse si një sistem i jashtëm rezervuari, ju lutemi bëni edhe fotografinë e rezervuarit.

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e çatisë/kulmit para instalimit të panelit diellor për ujë të ngrohtë</li> <li>Fotografi e punimeve të instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e panelit të ri diellor për ujë të ngrohtë</li> <li>Fotografi e etiketës së të dhënave (duke përfshirë prodhuesin, modelin, specifikimet teknike)</li> <li>Fotografi e pajisjeve ndihmëse të instaluar (p.sh. rezervuar akumulues i ujit)</li> </ul>

**Shembull:**

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e çatisë/kulmit para/gjatë instalimit të panelit të ri diellor për ujë të ngrohtë</li> </ul> 	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e panelit të ri diellor për ujë të ngrohtë</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografia e etiketës me të dhëna</li> </ul>  <ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e pajisjeve ndihmëse (e rezervuarit akumulues të ujit të</li> </ul>



## 9 Sisteme fotovoltaike (panele diellore për prodhim energjie)

Për instalimin e sistemeve diellore fotovoltaike është e nevojshme të bëhen fotografi **para, gjatë dhe pas përfundimit** të punimeve.

Para zbatimit të projektit është e nevojshme të bëni fotografi të ambienteve (p.sh. çatisë/kulmit) ku do të vendoset sistemi fotovoltaik (panele diellore për prodhim energjie).

Pas zbatimit është e nevojshme të bëni fotografi të Sistemit të Paneleve Diellore Fotovoltaike të instaluar.

Përveç kësaj, gjatë procesit të instalimit duhet të bëni fotografi që tregojnë punën aktuale dhe etiketën me të dhënat e paneleve fotovoltaike, inverterit dhe sistemit të baterisë (nëse është instaluar).

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e vendit ku do bëhet instalimi i paneleve fotografike (përpara zbatimit).</li> <li>▪ Fotografi e punimeve të instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e sistemit të ri fotovoltaik</li> <li>▪ Fotografi e inverterit</li> <li>▪ Fotografi e etiketës me të dhënat e paneleve fotovoltaike (duke përfshirë prodhuesin, modelin)</li> <li>▪ Fotografia e baterive (nëse janë instaluar)</li> </ul>

### Shembull:

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e çatisë/kulmit para/gjatë instalimit të sistemit të ri fotovoltaik (ndërtimi mbështetës i instaluar)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e sistemit të ri të paneleve diellore fotovoltaike</li> </ul>



- Fotografi e inverterit



- Foto e etiketës me të dhënat e paneleve fotovoltaike (duke përfshirë prodhuesin, modelin)



## 10 Rezervuar akumulues për ujë të ngrohtë

Për instalimin e rezervuarëve akumulues për ujë të ngrohtë, është e nevojshme të bëni fotografi **para, gjatë dhe pas përfundimit** të punimeve.

Në rastin e zëvendësimit të pajisjeve ekzistuese me pajisje me efikasitet energjetik, është e nevojshme të bëni një fotografi të rezervuarit që do të zëvendësohet. Në rast të instalimit të një rezervuari të ri, duhet të bëni dhe të dorëzoni fotografinë e rezervuarit të ri pas instalimit.

Përveç kësaj, duhet të bëni një fotografi të etiketës me të dhënat e rezervuarit.

Kërkesat e nevojshme janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:


Supported by:





Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi para/gjatë instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografitë e rezervuarit të vjetër, nëse ka</li> <li>Fotografitë e punimeve të instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografitë e rezervuarit të ri</li> <li>Fotografinë e etiketës me të dhënat (duke përfshirë prodhuesin, modelin, specifikimet teknike)</li> </ul>

**Shembull:**

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografia pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Foto e Rezervuarit të vjetër</li> </ul> 	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografia e Rezervuarit të ri</li> <li>Fotografi e etiketës me të dhënat (duke përfshirë prodhuesin, modelin, specifikimet teknike)</li> </ul>  

**11 Ventilim mekanik me rikuperim nxehtesie**

Për instalimin e sistemeve të ventilimit mekanik, është e nevojshme të bëhen fotografi **para, gjatë dhe pas përfundimit** të punimeve.

Supported by:



Para zbatimit të projektit, është e nevojshme të bëni fotografinë e vendndodhjes/ambientit ku do të instalohet njësia e ventilimit.



Pas instalimit është e nevojshme të bëni fotografinë e sistemit të instaluar të ventilimit.

Përveç kësaj, gjatë procesit të instalimit duhet të bëni fotografi që tregojnë punën aktuale dhe etiketën me të dhënat e njësisë së ventilimit.

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Foto para/gjatë instalimit	Foto pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e vendit ku do instalohet sistemi i ri i ventilimit</li> <li>Fotografi e punimeve të instalimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e sistemit të ri të ventilimit</li> <li>Fotografi e etiketës së të dhënave (përfshirë prodhuesin, modelin, specifikimet teknike)</li> </ul>

**Shembull:**

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e vendit të instalimit para/gjatë instalimit të sistemit të ri të ventilimit</li> </ul> 	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fotografi e sistemit të ri të ventilimit</li> <li>Fotografi e etiketës së të dhënave (duke përfshirë prodhuesin, modelin, specifikimet teknike)</li> </ul> 

Supported by:





## 12 Ndryçim me efikasitet të lartë

Për instalimin e sistemeve të ndryçimit me efikasitet të lartë, është e nevojshme të bëni fotografi **para** dhe **pas përfundimit** të punimeve.

Kërkesat janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Fotografi para/gjatë instalimit	Fotografi pas instalimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e sistemit të vjetër të ndryçimit, nëse ka</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Fotografi e sistemit të ri të ndryçimit</li> </ul>

Supported by:

